



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:014340

Datë: 16.11.2021

Numri i dokumentit: 02404826

PKR.nr.30/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda, nga trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët Shaqir Zika- kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarët Drilon Haraçia dhe Nikollë Komani- anëtarë të trupit gjykues me sekretaren juridike Nushe Kadrija, në çështjen penale kundër të akuzuarës Z. P. nga Gjakova, për shkak të veprës penale falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të ish KPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë- Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP/I.nr.13/2021 të dates 24.02.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me datën 15.11.2021, në prezencën e Prokurores së shtetit Ardita Beqiraj- Hyseni të akuzuarës Z. P. si dhe mbrojtëses së sajë av. Zahide Gjoni, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 16.11.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

Z. P. e bija e A., e ëma N., e gjinisë D., data e lindjes . . . në Gjakovë, ku edhe tani banon në rrugën “ . . . , ka të kryer fakultetin e shkencave kompjuterike, e pamartuar, e gjendjes së mesme ekonomike, me profesion IT, me numër personal . . . , Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Më dt.11.06.2017 në Gjakovë, duke keqpërdorur pozitën apo autorizimin e saj lidhur me zgjedhjet ka regjistruar në mënyrë të pasaktë rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore, në atë mënyrë që e pandehura ditën kritike e cila ishte e autorizuar nga KQZ si kryesuese e komisionit zgjedhor në vendvotimin me numër 0203X/03R që gjendej në Shkollën e mesme “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, pikërisht pas numërimit të votave në FRK (Formularin i Rezultateve të Kandidatëve) në kundërshtim me nenin 102 parg.2 të Ligjit NR.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ka regjistruar gabimisht votat e kandidatëve, duke regjistruar 203 vota, prej tyre 131 vota te shtuara dhe 72 vota te hequra, me ç ‘rast me gjithsej 203 vota i ka dëmtuar kandidatët e ndryshëm brenda subjekteve politike për zgjedhjet e përgjithshme.

- **Me këto veprime ka kryer veprën penale: Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 53, 62, 63, 66, 73, 74, 75, 76 par.1 nën par.1.3, dhe nenit 219 par.2/1 të KPRK-së, të akuzuarës i shqipton:

D Ë N I M I N M E K U S H T

Duke ia vërtetuar **dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti**, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse e akuzuara brenda afatit të verifikimit një (1) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Ndaj të akuzuarës Z. P., i shqiptohet edhe:

D Ë N I M I P L O T Ë S U E S

NDALIMI – HEQJA E TË DREJTËS PËR TU ZGJEDHUR DHE NDALIMI I USHTRIMIT TË PROFESIONIT, I VEPRIMTARISË OSE DETYRËS, ashtu që i ndalohet e drejta për tu zgjedhur si kandidat për zgjedhjet Lokale apo Qendrore në Republikën e Kosovës, po ashtu i ndalohet ushtrimi i detyrës që të marrë pjesë në zgjedhje lokale apo qendrore si vëzhguese, kryesuese, komisionere apo pozita tjera apo të ngjashme të cilat kanë të bëjnë me zgjedhjet lokale apo qendrore të organizuara nga KQZ-ja, në kohëzgjatje **prej 4 (katër) vite**, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Detyrohet e akuzuara, që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.13/2021 të dates 24.02.2021, kundër të akuzuarës Z. (A.) P. nga Gjakova, për shkak të veprës penale falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar me datën 22.04.202, në të cilën seancë kanë marr pjesë Prokurorja e shtetit Ardita Beqiraj Hyseni, e akuzuara si dhe mbrojtësja e tij av. Zahie Gjonaj.

E akuzuara Z. P., gjatë shqyrtimit fillestar është deklaruar e pafajshme për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës.

Pasi që aktakuza është konfirmuar gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesorë me datat 15.11.2021, ku ka prezantuar përfaqësuesi i akuzës prokurorja e shtetit Ardita Beqiraj Hyseni, e akuzuara Z. P. si dhe mbrojtësja e sajë av.Zahide Gjonaj.

Pas leximit të aktakuzës, gjykata është e bindur se e akuzuara ka kuptuar aktakuzën, të njëjtës i është dhënë mundësia që të deklarohet për pranim apo mos pranim të fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë konform nenit 248 par.1 pika 1.1 dhe 1.4 të KPP-së.

E akuzuara Z. P. pas njoftimit mbi të drejtat e saja dhe konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e sajë e njëjta është deklaruar e fajshme për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarës, gjykata ka kërkuar mendim nga prokurorja lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurorja e Shtetit Ardita Beqiraj- Hyseni duke dhënë mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës, pasi e njëjta ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë me vetëdije dhe vullnet të plotë si dhe pranimi i fajësisë mbështetet në provat në të cilat mbështetet edhe aktakuza, i propozojë gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë.

Mbrojtësja e të akuzuarës Z. P.,av.Zahide Gjonaj, ka deklaruar se pas konsultimeve të mjaftueshme me të mbrojturën time i kam shpjeguar të gjitha favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë, e njëjta pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës pa ndikim dhe pa presion, pa lajthim, andaj i propozoi gjykatës që ta aprovoi pranimin e fajësisë të bërë nga e akuzuara.

Pas marrjes së mendimit nga ana e prokurores së shtetit dhe marrjes së mendimit nga mbrojtësja e të akuzuarës, në shqyrtim gjyqësor, trupi gjykues ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë trupit gjykues konstatoi se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga e akuzuara, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e saj av. Zahide Gjonaj, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, dhe atë libri i votimit, formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve me numërim të vetë votimit, 0203x/03R, formulari i rezultatit të kandidateve me numër të vendvotimit 0203x/03R, formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve pas rinumërimit të votave, tabela e specifikuar (ni Exell) me emrin e kandidatit, subjektit politik dhe pasqyra e votave të numëruara dhe rinumëruara, akti përcjellës i Kryeprokurorit të Shtetit me numër PPN.nr.30/2020 të datës 19.05.2020, shkresa njoftuese, për pasaktësinë e identifikuar nga KQZ-ja, rastet nën hetim të identifikuar nga KQZ-ja, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Meqenëse e akuzuara ka pranuar fajësinë gjykata ka kaluar në fjalën përfundimtare

Prokurorja e shtetit Ardita Beqiraj Hyseni, në fjalën e sajë përfundimtare ka deklaruar se ngeli në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik dhe se këtu e akuzuara në fillim të seancës së shqyrtimit gjyqësor ka pranuar fajësinë, andaj konsideroj se në tërësi është vërtetuar se e njëjta ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj i propozoi gjykatës që të njëjtën ta shpalli fajtorë, ta dënoi në bazë të ligjit po ashtu ti shqiptohet dënimi plotësues ndalimi i funksionit në zgjedhje si anëtare apo kryetare e komisionit. Me rastin e vendosjes lidhur me sanksionin penal gjykata të merr parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese që qëndrojnë në këtë çështje penale.

Mbrojtësja e të akuzuarës av.Zahide Gjonaj, në fjalën e sajë përfundimtare ka deklaruar se e mbrojtura ime në fillim të seancës së shqyrtimit gjyqësor ka pranuar fajësinë për veprën

penale që i vihet në barë sipas aktakuzës, pranimin e fajësisë e ka bërë vullnetarisht pas konsultimeve me mua si mbrojtëse, andaj i propozoi gjykatës që me rastin e sanksionit penale të merr për bazë si rrethanë posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë, e njëjta ka premtuar që nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme penale, andaj ndaj të njëjtës ti shqiptohet një dënim sa më i butë të paraparë me ligj dhe atë nën minimumin e mundshëm ligjor dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me ligj.

E akuzuara Z. P. në fjalën e sajë përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtëses sime duke shtuar se në rastin konkret veprimet që i ka bërë kanë qenë nga lodhja e tepërt dhe unë nuk kam pasur qëllim ta dëmtoj ndokënd nga kandidatët apo subjektet politik, andaj i propozoi gjykatës që të më shqiptoi një dënim sa më të butë të paraparë me ligj, dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të kryej veprime të tilla apo të ngjashme penale.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, trupi gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se e akuzuara Z. P., me dashje ka kryer veprën penale falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 219 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se këtë formë të kësaj vepre penale falsifikimi i rezultateve zgjedhore e kryen “*Kushdo që shton, heq apo fshin votat apo nënshkrimet, regjistron në mënyrë të pasaktë votën apo rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore, ose publikon votën apo rezultatet e zgjedhjeve apo të votimit që nuk i përgjigjen votimit të vërtetë, ose në ndonjë mënyrë tjetër falsifikon votën apo rezultatet e zgjedhjeve, dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet. Ndërsa paragrafi 2. Parasheh “Kur vepra penale nga par.1, i këtij neni kryhet nga anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij lidhur me zgjedhjet, kryesi dënohet prej tre (3) deri në pesë (5) vjet”.* Kështu që duke u bazuar në këto dispozita ligjore, Gjykata, e ka shpallur fajtores të akuzuarën Z. P., për shkak të veprës penale falsifikimi i rezultateve zgjedhore nga neni 219 paragrafi 2 lidhur me par.1 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtës i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarës: jeton me 8 anëtare të familjes, e gjendjes së dobët ekonomike, nuk ka qenë asnjëherë e dënuar për ndonjë vepër penale në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pendimin e saj dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, koha e kaluar që nga kryerja e veprës penale. Si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin kryesor. Ndërsa si rrethanë rënduese kjo Gjykatë nuk gjeti për të akuzuarën. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarën, gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret eksitojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 75 par.1 nën par 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së dhe në rastin konkret ka aplikuar dispozitën e nenit 76 par.1 nenpara.1.3 të KPRK-së, kur ka shqiptuar

dënimin me burgim nën kufirin e paraparë me ligj si në dispozitiv të aktgjykimit për të akuzuarën dhe ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6. Dënimi plotësues

Duke u bazuar në nenin 62, 63 dhe 66 të KPRK, përveç dënimit alternativ (dënimit me kusht), ndaj të akuzuarës Z. P., është shqiptuar edhe dënimi plotësues heqja e të drejtës për tu zgjedhur dhe ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, në kohëzgjatje prej 4 viteve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Pra të njëjtës i ndalohet e drejta për tu zgjedhur si kandidate për zgjedhjet lokale apo qendrore në Republikën e Kosovës, po ashtu i ndalohet ushtrimi i detyrës që të marrë pjesë në zgjedhje lokale apo qendrore si vëzhgues, kryesues, komisionar apo pozita të tjera apo të ngjashme të cilat kanë të bëjnë me zgjedhjet lokale apo qendrore të organizuara nga KQZ-ja. Andaj, Gjykata e ka shqiptuar këtë dënim plotësues, siç parashihet edhe në nenin 62 paragrafi 1 dhe 2 nën par.2.1 dhe 2.4 të KPRK-së, Meqenëse *“Kryesit të veprës penale” si në rastin konkret pasi që duke shfrytëzuar pozitën e kryesuesit ka bërë falsifikimin e votave, gjykata mund t’ia shqiptojë dënimin plotësues duke vlerësuar se shqiptimi i këtij dënimi plotësues është i domosdoshëm për tu arritur qëllimi i dënimit.*

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.30/2021, me datë 16.11.2021

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Kryetari i trupit gjyqës,
Shaqir Zika

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.